



Themelimi i iniciativës së refugjatëve Jugendliche ohne Grenzen NRW & Flüchtlingsrat NRW

Në ditët e sotme tema e arratisjes dhe azilit qëndron përsëri në fokus. Flitet shpesh për refugjatët, por jo me ta. Organizatat e pavarura të refugjatëve duan ta ndryshojnë këtë. Duhet të mundësohet ajo, që të arratisurit të flasin për veten e tyre dhe të kontribuojnë në punën sqaruese lidhur me temat sie azili politik dhe arsyet e arratisjes. Kjo listë kontrolli është bërë nga iniciativa e refugjatëve „të rinj pa kufi“, të cilët angazhohen që prej shumë vitesh për një zë të fortë të refugjatëve në publik. Prandaj kjo listë kontrolli shërben kryesisht në punën politike.

Përpara themelimit

Sipas mendimit tonë është e rëndësishme, që motivimi i themelimit del nga vetë të arratisurit dhe për këtë nuk janë iniciatorë vullnetarët/vullnetaret. Për më tepër është i rëndësishëm një vlerësim fillestar i gjendjes lokale e të arratisurve në vend.

- Sa dhe si janë strehuar?
- Kush është përgjegjës për strehimin dhe kujdesin?
- Nga cilat vende vinë ata?
- Cilat gjuhë janë të nevojshme për komunikim?

Përgatitja e takimit të themelimit

- Mjediset: Këto duhet të jenë politikisht neutrale dhe të vendosura në qendër.
- Përgatitja për ftesë: Të arratisurit mbështeten nga vullnetarët. Por vullnetarët duhet të qëndrojnë pasivë sa më shumë që të jetë e mundur.
 - Të arratisurit: Ftesat shpërndahen si fletushka nëpër vendstrehime në gjuhët përkatëse; shpërndarësit duhet që gjatë shpërndarjes të mbulojnë të gjitha gjuhët. Në rast se ekzistojnë pyetje të hapura, atëherë këto duhet të sqarohen menjëherë.
 - Vullnetarët: Ftesat të ekspozohen në formën e fletushkave nëpër shkolla, qendra rinore, shoqata për mirëqenie, kisha etj.; veç kësaj reklama lidhur me shtypin lokal, si radio dhe gazeta ditore

Zhvillimi i takimit të themelimit

- Prezantimi i personave të pranishëm dhe
- Mbledhja e të dhënave kontaktuese përmes listës së pjesëmarrësve
- Të bëhen fotografi nga themelimi (Pjesëmarrësit/pjesëmarrëset të pyeten për lejen)
- Paraqitja e sfidave lokale dhe barrierave për refugjatët
- Të paraqiten në to arsyet për themelimin
- Të mblidhen ide dhe propozime për zgjidhje
- Të shpërndahen përgjegjësi dhe detyra
- Të krijohen shpërndarës informacioni (p.sh. E-mail, Facebook apo WhatsApp)
- Të bihet dakord për takime në vazhdim (rekomandohen të qëndrojnë të njëjtat ditë të javës dhe i njëjti orar)





Themelimi u arrit – Po më tej?

Pas takimit të themelimit të gjithë pjesëmarrësit do të jenë shumë të motivuar. Për ta sistemuar siç duhet këtë motivim dhe për të filluar menjëherë që ditën në vazhdim, kjo është më e rëndësishmja për një themelim. Përndryshe do të ngelet në harresë dhe do të pasojnë zhgënjimet. Prandaj të rinjtë pa kufi ju japin ju këshillat e mëposhtme:

- Të publikohet njoftimi për shtyp në gazetën ditore lidhur me themelimin, dhe në këtë mënyrë të ftohen të interesuar të tjerë
- Të vendosen kontakte me operatorët dhe përgjegjësit e strehimit
- Të krijohet rrjeti me organizatat ndihmëse, shoqatat për mirëqenie, shoqatat antifashiste, partitë etj.
- Të planifikohen dhe të realizohen veprimet

Çfarë veprimesh?

Veprimet duhet të orientohen tek problemet ekzistuese lokale të të arratisurve. Duhet bërë përpjekje për tërheqjen e vëmendjes ndaj sfidave dhe barrierave të refugjatëve dhe të zgjidhen ato.

E rëndësishme: Shumë barriera dhe mangësi tregohen jo vetëm në nivel lokal, por edhe në nivel shtetëror dhe federal. Probleme të tilla shpesh nuk mund të zgjidhen në nivel lokal, por tërhiqet vëmendja në to.

Shembuj mbi veprimet

- Demonstrata dhe mitingje
- Diskutime në podium (podiumi të mbushet ndër të tjerë edhe me të arratisur)
- Publikimi në shtypin lokal i çrregullimeve lokale
- Festa fetare (krishtlindjet, ramazani, etj.) dhe festa jofetare
- Takime me politikanët e qytetit
- Të përgatiten dhe të shpërndahen fletushka dhe broshurat lidhur me temën azili politik dhe arsyet e arratisjes
- Të ofrohen seminare dhe Workshops nëpër shkolla dhe universitete

Të dhëna kontaktuese

Jugendliche ohne Grenzen NRW

Bintou, Landeskoordinatorin von JoG NRW:
Tel.: 0174 9381668

ehrenamtlicher Unterstützer von JoG NRW:
Tel.: 0157 55583395

E-Mail: presse@jogspace.net
www.jogspace.net

facebook.com/JoGNRW

Flüchtlingsrat NRW

Geschäftsstelle Flüchtlingsrat Nordrhein-Westfalen e. V.
Wittener Straße 201
44803 Bochum

Tel: 0234 587315 6

Fax: 0234 587315 75

Montag bis Freitag 10 - 16 Uhr

E-Mail: info@frnrw.de

www.frnrw.de

„Të rinjtë pa kufi NRW“ qëndron me kënaqësi në dispozicion në rast pyetjesh!
